



Thirrje për pjesëmarrje në trajnimin “Vizualizimi i të Dhënave”

Jeni gazetar dhe punoni për media online, të shkruara apo transmetuese? Dëshironi të inkorporoni të dhëna në punën tuaj në mënyra të reja dhe interesante?

Misioni i OSBE-së në Kosovë ofron trajnim dyditor për gazetarë mbi Vizualizimin e të Dhënave. Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë, regjistrohuni në <https://bit.ly/2wEuVve> deri më 27 maj 2018.

Gjatë punëtorive, gazetarët do të trajnohen për përfshirjen e të dhënave në storiet e tyre. Do të mbulohen tema si: roli i të dhënave në redaksi, si të gjenden të dhëna legjitime dhe relevante, qasjet për analizimin e të dhënave për të identifikuar storie bindëse, dhe prezantimi i qartë i të dhënave. Trajnimi do të mbahet nga Cactus, kompani vendore e specializuar në vizualizim të të dhënave.

Data dhe koha: 4-5 qershor nga 09:00 deri 18:00, dhe
6-7 qershor, nga 09:00 deri 18:00

Vendi: Rruga Bashkim Fehmiu, Arbëri 3 BC2/11 V1- L01-S, 10000 Prishtinë

Vendet për trajnim janë të kufizuara dhe do të ndahen sipas radhës së paraqitjes.